



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova – Republic of Kosovo**

**Komuna e Prishtinës**  
**Opština Priština –Municipality of Prishtina**



---

## EKSTRAKTI I PROCESVERBALIT

**të mbledhjes së dymbëdhjetë të Kuvendit të Komunës së Prishtinës, mbajtur më 27.12.2012, e cila filloi në orën 11:00.**

**Në mbledhje morën pjesë:** prof. dr. Isa Mustafa, kryetar i Komënës, Avdullah Hoti, nënkryetar i Komunës, Sami Hamiti, kryesues i Kuvendit, këshilltarët: Hazir Borovci, Shaip Hajrizi, Ismail Kosumi, Hetem Kupina, Vjollca Dibra - Ibrahim, Rrahman Ismajli, Rexhep Mustafa, Tefik Mehmeti, Avdush Dobratiqi, Premtina Rakovica, Muhamet Nura, Fetah Salihu, Vjollca Rizani, Ajnishahe Azemi, Mustafë Krasniqi, Sarandë Sadriu, Arta Krasniqi, Luan Jusufi, Sali Krasniqi, Naime Osmani, Bajram Selimaj, Musli Mehaj, Agim Krasniqi, Flamur Shala, Nexhmije Berisha, Aziz Pacolli, Milazim Vitia, Naim Makolli, Donika Surdulli, Nerxhivane Vitia, Sofije Kllokoqi, Valon Hiseni, Shemsi Veseli, Lumnie Rama, Liridon Restelica, Skënder Reçica, Besa Halimi - Zagragja, Shefqet Sylejmani, Meliza Haradinaj, Astrit Hasani, Mejreme Berisha, Shefki Gashi, Besa Rafuna, Feti Mejdiu, Kimet Zeqa, Sadri Ramabaja, Afërdita Veliu dhe Engin Beyoglu.

**Munguan:** Bekim Gashi dhe Remzi Pacolli.

**Morën pjesë edhe** drejtorët e drejtorive, përfaqësues të Ministrisë së Pushtetit Lokal, të OSBE – së, të INPO-së, të shoqërisë civile dhe të mjeteve të informimit.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi **Sami Hamiti**, kryesues i Kuvendit.

Fillimisht **kryesuesi** hapi diskutimin rreth rendit të ditës.

**Naim Makolli** kërkoi një sqarim rreth ndarjes së njëqindmijë eurove si ndihmë për shërbyesit civilë të Komunës së Prishtinës, duke shtuar se a ka qenë e paraparë të ndahen mjete, apo të jepen në formë të taloneve apo triskave. Ndarja e tyre ose furnizimi i shërbyesve civilë të Komunës së Prishtinës prej vetëm dy kompanive në komunën e Prishtinës, kisha dashur ta di a ka qenë përmes ndonjë tenderi, apo si ka shkuar procedura.

**Meliza Haradinaj** tha se e konsideroj të rëndësishme që sot nga ky kuvend, në mbledhjen e fundit të këtij viti, por edhe në trevjetorin e inaugurimit të këtij kuvendi, të kërkojmë nga institucionet qendrore që të shtojnë angazhimin dhe përkushtimin për miratimin e Ligjit për Prishtinën në vitin 2013, ashtu siç është përcaktuar edhe me nenin 13 të Kushtetutës.

**Sadri Ramabaja** një vit më parë, në takimin tonë të fundit në godinën e re të Komunës, kam pas shtruar një kërkesë që dua ta përsërisë prapë. Me qëllim që punimet e këtij kuvendi të jenë sa më të hapura, me qëllim që komunikimi ynë të jetë sa më i drejtpërdrejtë me qytetarë, me qëllim që qytetarët ta shohin drejtpërdrejt angazhimin e secilit prej këshilltarëve këtu, unë përsëris kërkesën që, për vitin e ardhshëm, ta shqyrtojmë si mundësi hapjen e një televizioni të qytetit, i cili njëri prej detyrave kryesore do ta kishte transmetimin e drejtpërdrejtë të mbledhjeve të këtij kuvendi.

Lidhur me çështjen e ndarjes së ndihmave shërbyesve civilë të Komunës, **Avdullah Hoti** dha sqarime lidhur me pyetjet e parashtruara, duke thënë se punëtorët atë vlerë e kanë marrë në mallra, dhe ato mallra janë blerë në bazë të procedurave të hapura të prokurimit, si çdo procedurë tjetër në përputhje me Ligjin e prokurimit, pasi që në formën “kesh” nuk kemi pasur mundësi në bazë të kufizimeve që ka Komuna.

Sa i përket kërkesës së z. Ramabaja, nuk di që ndonjë vend demokratik në botë ku institucionet të kenë hapur kanale televizive. Nëse ka ndonjë përvojë të tillë, ta shohim si mund të zbatohet edhe te ne.

Lidhur me çështjen e potencuar nga z. Makolli rreth ndarjes së ndihmave për shërbyesit civilë, **kryesuesi** tha se është konfirmuar edhe nga monitoruesit e Ministrisë së Pushtetit Lokal, se vendimi është i ligjshëm dhe ndarja e mjeteve në aspektin procedural është kryer si duhet.

**U konstatua se njëzëri u miratua ky**

## R E N D D I T E :

1. Miratimi i ekstraktit të procesverbalit të mbledhjes së njëmbëdhjetë;
2. Propozimrregullorja për menaxhimin e mbeturinave në territorin e Komunës së Prishtinës;
3. Propozimvendimi për vazhdimin e afatit të dhënies së pronës komunale në shfrytëzim me qira Agjensionit për Përkrahjen e Punësimit në Kosovë -APPK;
4. Propozimvendimi për dhënien e strehimores publike në shfrytëzim të përkohshëm;
5. Propozimvendimi për dhënien e objektit nr. 2 të zjarrfikësve në shfrytëzim dhe menaxhim të përkohshëm NPK “Hortikultura” SH.A. Prishtinë;
6. Propozimvendimi për dhënien e pronës komunale - hapësirën e bufesë në shfrytëzim me qira;
7. Propozimvendimi për caktimin e anëtarëve të kuvendit të komunës në komisionin për dhënien e pronës komunale në shfrytëzim me qira;
8. Pyetje dhe përgjigje;
9. Të ndryshme.

## **Pika e parë**

**Sadri Ramabaja** bëri vërejtje në ekstraktin e procesverbalit, duke thënë se nuk po shënohen emrat e të gjithë atyre që votojnë kundër apo abstenojnë, sidomos në rastet kur pikat janë relativisht të ndjeshme, do të duhej të shënohej emri i votuesit. Qytetarët duhet të dinë se cili prej këshilltarëve, çfarë pozicionimi politikë ka.

**Me vërejtjen e dhënë, njëzëri u miratua ekstrakti i procesverbalit të mbledhjes së njëmbëdhjetë të Kuvendit.**

## **Pika e dytë**

**Lidhur me Propozimrregulloren për menaxhimin e mbeturinave në territorin e komunës së Prishtinës, të pranishmit i njoftoi Agim Salihu, shef i Zyrës ligjore.**

**Kryesuesi hapi diskutimin lidhur me shqyrtimin e kësaj pike.**

**Mustafë Krasniqi**, në emër të GP të LDK-së, tha se e kemi shqyrtuar dhe analizuar këtë rregullore. Vërejtjet që janë dhënë në mbledhjen e KPF-së janë marrë parasysh, prandaj si GP e përkrahim dhe do ta votojmë këtë rregullore për miratim.

**Aziz Pacolli**, në emër të GP të AKR-së, shprehu mendimin se kjo rregullore vlen vetëm atëherë kur të plotësohen kushtet për klasifikimin e mbeturinave.

Disa nga vërejtjet që duhet cekur, janë: në faqen 4, pikat 7 dhe 8, që parashohin orarin dhe dinamikën e mbledhjes së mbeturinave. Gjatë mbledhjes së mbeturinave, në mëngjes zakonisht kemi tollovi shumë të mëdha, andaj do të duhej që mbledhja e tyre të bëhet nga ora 12:00 deri në orën 5:00, pra t'i iket orarit që ka ngarkesë të madhe në qytet nga ora 7:00 - 8:00, në mënyrë që qytetarët të kenë mundësi të shkojnë në punë sa më shpejt. Vendosija e kontejnerëve të bëhet në vendet ku nuk pengojnë qytetarët.

Flitet për deponitë, mendoj se për këtë duhet të jetë një deponi që i plotëson kriteret.

Në KPF kam bërë një vërejtje rreth dënimeve që duhet të parashihen, andaj dhe kërkova që të bëhet zberthimi i tyre, dhe propozoj që dënimi për bizneset e ndryshme, të cilat i shfrytëzojnë kontejnerët publikë për hedhjen e mbeturinave, të jetë 100 €, si dhe për derdhjen e mbeturinave nga automjetet gjatë transportimit për në impiantet për trajtim apo për deponim në deponi të mbeturinave, dënimi maksimal të jetë po ashtu 100 €.

Gjithashtu, do duhej të parashiheshin edhe dënime për hedhjen e mbeturinave nga automjetet në lëvizje, dhe propozoj që ato dënime të jenë nga 30 € deri në 50 €.

Me këto vërejtje dhe sugjerime, këtë rregullore e përkrahim për miratim.

**Shemsi Veseli**, në emër të GP të PDK-së, tha se sa i përket kësaj rregulloreje, konsideroj që është e harmonizuar në kuadër të ligjit. Pra, unë e përgëzoj Zyrën ligjore që është munduar shumë shpejt ta përgatisë, së bashku me ekzekutivin, dhe ta sjellë para nesh që ta miratojmë. Kjo është në kuadër të obligimit tonë, prandaj dhe jemi për miratimin e saj.

**Shefqet Sylejmani**, në emër të GP të AAK-së, tha se ne për këtë rregullore i kemi dhënë sugjerimet tona në KPF dhe të gjitha ato janë përfshirë në këtë dokument. Kemi pasur vërejtje pak substanciale, ndërsa shumica kanë qenë formale. Mbetet angazhim ynë që të punohet dhe veprohet në vetëdijesimin e qytetarëve, në rend të parë, e më pak të gjobiten qytetarët.

E përkrahim plotësisht këtë Rregullore për miratim.

**Shefki Gashi**, në emër të GP të LDD-së, u shpreh se kjo rregullore ka një mangësi, sepse trajtohet vetëm qyteti, pjesët urbane, ndërsa në masë anashkalohet pjesa rurale, kështu që duhet pasur kujdes, sepse sasia më madhe e mbeturinave të ngurta dhe mbeturinave tjera hidhen nëpër pjesët periferike të Prishtinës, ndotet ambienti nëpër mjedise përreth Prishtinës, kështu që ajo kompani që bën grumbullimin e mbeturinave, t'i mbledhë ato në tërë territorin e komunës së Prishtinës, pa dallim. Këtu shpenzohen taksat e qytetarëve, prandaj duhet të kryhen shërbimet në mbarë territorin e komunës së Prishtinës. E përkrahim këtë Rregullore, por me një sugjerim, që kompania duhet t'i përmbushë të gjitha obligimet kontraktuese, si mbajtjen e kontejnerëve në vendet të pastra etj.

**Feti Mehdiu**, në emër të GP të Partisë së Drejtësisë, uroi për ngritje sa më të lartë të vetëdijes së qytetarëve për pastrimin. Pjesërisht u pajtua jo me shumën e dënimeve, por me një aksion, ku Prishtina si kryeqytet do t'u jepte një shembull qyteteve tjera të Kosovës me ndërmarrjen praktike të atyre masave. Do të ishte mirë ta përjetojnë qytetarët nëse e ndotin ambientin, të marrin disa sanksione, në njëfarë mënyre të marrin një lloj dënimi. Pavarësisht që Ministria i cakton gjobat, Komuna e Prishtinës duhet të marrë ndonjë hapë më të guximshëm dhe më konkret. Rregulloren e përkrahim për miratim, pa ndonjë shtesë tjetër të veçantë.

**Afërdita Veliu**, në emër të Lëvizjes Vetëvendosje (LV), tha se në parim e mbështesim këtë rregullore, sepse fundja perspektiva e menaxhimit të mbeturinave duhet të shkojë në këtë drejtim, megjithatë ne mendojmë dhe gjykojmë se Komuna nuk i ka bërë përgatitjet e duhura, duke përfshirë këtu edhe infrastrukturën, në mënyrë që ky objektiv të realizohet. LV para disa ditësh ka bërë edhe një reagim lidhur me blerjen e kontejnerëve nga Serbia, dhe mendojmë se një vendim i tillë është shumë i pamatur, andaj si të tillë e gjykojmë ashpër, sepse në këtë mënyrë nuk ndihmohet dhe nuk zhvillohet ekonomia e vendit.

**Njëzëri u miratua Rregullorja për menaxhimin e mbeturinave në territorin e Komunës së Prishtinës.**

## **Pika e tretë**

**Lidhur me Propozimvendimin për vazhdimin e afatit të dhënies së pronës komunale në shfrytëzim me qira Agjensionit për Përkrahjen e Punësimit në Kosovë - APPK, të pranishmit shkurtimisht i njoftoi Agim Salihu.** Ai tha se Komuna e Prishtinës, në bazë të dispozitave të ligjeve dhe akteve nënligjore që kanë qenë në fuqi në vitin 2002, Akademisë Gjermane për të Rritur i ka dhënë në shfrytëzim dhe menaxhim objektin dhe oborrin e Arkivit Komunal të Prishtinës, në afat për 10 vjet. Duke pasur parasysh se ky afat ka kaluar, është propozuar vazhdimi i afatit të dhënies së objektit në shfrytëzim.

**Njëzëri u miratua Vendimi për vazhdimin e afatit të dhënies së pronës komunale në shfrytëzim me qira Agjensionit për Përkrahjen e Punësimit në Kosovë - APPK.**

## **Pika e katërt**

**Për Propozimvendimin për dhënie e strehimores publike në shfrytëzim të përkohshëm informoi Agim Salihu,** duke thënë se ky vendim ka të bëjë me dhënie e strehimores në shfrytëzim, e që është bazuar në Ligjin për mbrojtje nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë e tjera.

**Sadri Ramabaja** bëri një sugjerim, e që inkorporohet edhe me një pyetje publike. LV nuk ka informacion se për çfarë pretendon ta shfrytëzojë këtë strehimore ndërmarrja "Hortikultura", andaj do të ishte mirë që të na shpjegohet këtu publikisht. Në Kuvend do të duhej ta kishim një raport lidhur me arsyeshmërinë, pse jo edhe leverdinë që do të kishte Komuna. Në këtë kohë, sidomos në lëmin e biznesit, të ashtuquajtur "inkubator i biznesit", mund të shfrytëzohen edhe strehimoret e kësaj natyre, andaj do të ishte mirë të merren parasysh edhe mundësitë e tilla. Po të merreshin parasysh interesat e këtij lloj biznesi, Komuna do të përfitonte relativisht shumë, por në rast se ka diçka tjetër në projekt "Hortikultura", insistojmë që të na jepet një shpjegim publik dhe në rast se shkon në të mirë të qytetarëve, ne do ta votojmë për miratim.

**Agim Gashi,** drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve Publike, Mbrojtjes dhe Shpëtimit, tha se vendi ku ndodhet strehimorja është në mes të parkut në lagjen "Ulpiana". Për asnjë veprimtari tjetër nuk mund t'ia besojmë që t'ia japim atë strehimore në shfrytëzim. "Hortikultura" është kompani komunale, e cila e mirëmban atë park dhe ajo ka nevojë ta ketë një objekt aty ku mund t'ia mbajnë mjetet e punës, është fjala për mjetet e dorës me të cilat punojnë, të cilat punëtorët i shfrytëzojnë gjatë mirëmbajtjes së parkut dhe njëkohësisht kujdesen për ruajtjen e strehimores. Ajo është plotësisht në nëntokë dhe nuk ka asnjë element human që do të mund të destinohej për ndonjë veprimtari tjetër.

**Shemsi Veseli** përkrahu këtë si një propozim jashtëzakonisht të qëlluar. Duke pasur parasysh të kaluarën e kësaj stremimoreje, kur është shfrytëzuar edhe nga delikuentët e ndryshëm, në veçanti nga personat që janë të prirë të përdorin mjetet narkotike dhe, në anën tjetër, është shfrytëzuar edhe si deponi bërriloku, ku janë hedhë mbeturinat, mendoj që është mjaft pragmatik dhe vizionar ky propozim, që ta marrë ndërmarrja "Hortikultura" për ta shfrytëzuar për nevojave të veta. Mbetet obligim që, sipas nevojës, brenda 24 orëve, ashtu si obligon edhe Vendimi, ta bie në gjendje të rregullt në rast të ndonjë fatkeqësie natyrore.

Këtë propozimvendim e përkrahim për miratim.

**Njëzëri u miratua Vendimi për dhënien e stremimores publike në shfrytëzim të përkohshëm.**

**Pika e pestë**

**Lidhur me Propozimvendimin për dhënien e objektit nr. 2 të zjarrfikësve në shfrytëzim dhe menaxhim të përkohshëm NPK "Hortikultura" SH.A.**

**Prishtinë, të pranishmit i informoi Agim Salihu.**

**Aziz Pacolli** tha se ndërmarrja "Hortikultura" ka qenë në një gjendje shumë të keqe në mungesë të lokalit për zyrat e tyre. Meqë është kompani komunale, nuk ka nevojë që afati të jetë i kufizuar në 10 vjet. Në momentin që mund t'i duhet Komunës, është e udhës që ta marrë. Derisa të jetë "Hortikultura" kompani ekskluzive e Komunës, edhe objekti duhet t'i jepet në shfrytëzim për aq sa të jetë kompani komunale.

**Shefki Gashi** shprehu dilemë rreth shfrytëzimit të këtij objekti nga kjo kompani, duke shtuar se në pikëpamje gjeografike si shtrihen punët e Hortikulturës, me këtë po largohet nga pjesët që menaxhohen prej saj, siç janë: Taul-bahçja, Parku i qytetit, Gërmia, sheshet etj.

Përkundër kësaj vërejtjeje, e përkrah këtë propozimvendim për miratim, me qëllimin që ai objekt të mos mbetet i zbrazët.

**Vjollca Rizani**, në emër të GP të LDK-së, përkrahu këtë propozimvendim si shumë të qëlluar, duke i pas parasysh kushtet në të cilat ka punuar "Hortikultura", dhe e votojmë për miratim.

**Meliza Haradinaj** tha se edhe GP i AAK-së e përshëndet këtë Propozimvendim dhe nuk sheh ndonjë pengesë që ky objekt t'i jepet në shfrytëzim ndërmarrjes "Hortikultura".

**Njëzëri u miratua Vendimi për dhënien e objektit nr. 2 të zjarrfikësve në shfrytëzim dhe menaxhim të përkohshëm NPK "Hortikultura" SH.A.**  
**Prishtinë.**

## **Pika e gjashtë**

### **Agim Salihu informoi lidhur me Propozimvendimin për dhënien e pronës komunale – hapësirën e bufesë në shfrytëzim me qira.**

Prona që do të jepet në shfrytëzim me qira është në ndërtesën e Komunës, dhe qëllimi është ushtrimi i veprimtarisë së bufesë për nevoja të punonjësve dhe të tjerëve në nivel të shërbimit civil të organeve të administratës së Komunës së Prishtinës.

**Shemsi Veseli** tha se edhe ne si GP e kemi shqyrtuar këtë propozimvendim.

Megjithatë, dua të potencoj se, pavarësisht kësaj, me gjithë mirëkuptimin që edhe punëtorët që punojnë në hapësirën e institucionit të Komunës do ta kenë një bufe, duhet ta ngre një shqetësim, sepse përderisa ka hapësirë për bufe në objektin e Komunës, është dashtë të ketë hapësirë edhe për grupet parlamentare në kuadër të institucionit të Komunës. Patjetër që duhet të jetë një hapësirë ku do të jetë mundësia që qytetari t'i adresojë shqetësimet dhe kërkesat e veta.

Pavarësisht nga kjo, do ta votojmë për miratim këtë propozimvendim, por nuk e di se a do të vazhdojë i njëjti person që e mirëmban bufenë, apo do të jetë përmes prokurimit që do të zgjidhet operatori i cili do ta udhëheqë.

Lidhur me çështjen e ngritur nga z. Veseli për mirëmbajtjen e bufesë, **Kryesuesi** tha se mirëmbajtja e saj do të bëhet sipas procedurave ligjore të prokurimit. Nuk do të jetë i njëjti, në fakt nuk është i njëjti, sepse e mban Komuna edhe objekti bëhet për punëtorë e nuk bëhet për parti politike, pra do të jetë për punëtorët e administratës së Komunës.

**Mejreme Berisha**, në emër të GP të AAK-së, u shpreh në përkrahje të këtij propozimvendimi, por duke i plotësuar kushtet higjieno-sanitare.

**Aziz Pacolli** përkrahu propozimin që në objektin e Komunës të jetë një hapësirë për bufe, por përkrahu edhe kërkesën e z. Veseli që në objektin e Komunës të gjendet një hapësirë, zyrë për opozitën.

### **Njëzëri u miratua vendimi për dhënien e pronës komunale – hapësirën e bufesë në shfrytëzim me qira.**

## **Pika e shtatë**

### **Lidhur me Propozimvendimin për caktimin e anëtarëve të Kuvendit të Komunës në komisionin për dhënien e pronës komunale në shfrytëzim me qira informoi Agim Salihu.**

Ky propozimvendim është në harmoni me pikën 7 të Ligjit 03 L- 226, për dhënie në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës. Përzgjedhjen e fituesit do ta bëjë një grup punues, i cili do të caktohet nga ekzekutivi dhe Kuvendi i Komunës.

**Sadri Ramabaja** bëri vërejtje në parim rreth përcaktimit, respektivisht propozimeve të anëtarëve të këtij Komisioni për çështje të përcaktuara decidivisht. Komiteti për Politikë dhe Financa është një trup që ka të drejtë të bëjë propozime të kësaj natyre, por duke marr parasysh edhe faktin që një pjesë prej nesh nuk bëjnë pjesë në atë komitet, me qëllimin që të jetë gjithçka e hapur, propozoj që herëve të tjera të merret edhe mendimi i kuvendarëve. **Kryesuesi** tha se, në të ardhmen, për komisionet e tilla, të cilat do t'i formojë Kuvendi, do ta marrim në shqyrtim propozimin e dhënë nga z. Ramabaja.

**Njëzëri u miratua vendimi për caktimin e anëtarëve të Kuvendit të Komunës në komisionin për dhënien e pronës komunale në shfrytëzim me qira.**

**Pika e tetë dhe e nëntë  
Pyetje, përgjigje dhe të ndryshme**

**Shefqet Sylejmani** tha se edhe në Komitetin për Politik dhe Financa i kemi bërë lutje dhe kërkesë drejtorisë përkatës të Komunës së Prishtinës, që të vazhdohet me stolisjen e qytetit edhe në pjesët periferike, në veçanti rruga që vjen nga drejtimi i Podujevës dhe ajo në lagjen "Arbëria", si dhe rruga në drejtim të Makovcit. Janë këto qendrat e përparshme të Prishtinës, të cilat kanë mbetur kështu sikur të kishim hequr dorë nga kjo pjesë e qytetit. Kjo do të thotë për popullatën një freskim edhe një përbashkim në festat e fundvitit.

Ai falënderoi për vlerësimin e dhënë nga INPO-ja, ku janë dhënë vlerësime të larta, objektive dhe reale, të thëna të gjitha çështjet, preokupimet dhe angazhimet tona që i kemi pasur në kuadër të këtij viti në Kuvendin e Komunës së Prishtinës.

**Mejreme Berisha** tha se edhe në mbledhjen e kaluar kërkoja nga kryesuesi i Kuvendit ta përdorë autoritetin e tij për t'i ndalur këshilltarët dhe drejtorët e drejtorive të jenë prezent deri në fund të mbledhjes, d.m.th. para se të përfundojnë pikat: "Pyetje, përgjigje dhe të ndryshme".

Pyetja e dytë ka të bëjë me përgatitjet dimërore për mirëmbajtjen e rrugëve në fshatrat e Gollakut. Sa është përgatitur Komuna që këto fshatra të mos mbeten të izoluara gjatë sezonit të dimrit?

Problem tjetër është edhe çështja e kurseve private nëpër shkollat tona, sidomos në shkollat e mesme. Sa ka të drejtë mësuesi i lëndës të mbajë kurs privat me nxënësin e vet? Për këtë kërkoj përgjigje me shkrim.

**Vjollca Rizani, pyetje për drejtorin e Drejtorisë së Arsimit**

Çështja e mbajtjes së kurseve nga arsimtarët me nxënësit e tyre është një dukuri mjaft shqetësuese, që ne si arsimtarë po ballafaqohemi çdo ditë. Kërkoj nga drejtori që të ndërmerret diçka lidhur me këtë çështje, sepse kohëve të fundit kemi edhe reagime të prindërve, të cilët nuk mund t'iu



përgjigjen kërkesave të arsimtarëve, për të mos thënë i kushtëzojnë me nota nxënësit, dukuri e cila po shfaqet edhe nëpër fshatra e komunës së Prishtinës. Do të ishte mirë që, përmes ndonjë vërejtje apo disi ndryshe, të reagohej dhe të ndërpritet kjo dukuri, e cila dita ditës po rritet dhe është shumë shqetësuese.

Lidhur me shqetësimet e paraqitura rreth mbajtjes së kurseve nga arsimtarët, **Halim Halimi**, drejtor i Drejtorisë së Arsimit, tha se çështja e mbajtjes së kurseve nga arsimtarët, mësimdhënësit, është një dukuri, e cila ka qenë edhe më parë dhe po vazhdon edhe tani. Drejtoria ka bërë përpjekje për ta ndaluar këtë, mirëpo me këtë çështje është më mirë të merret më tepër Inspekcioni arsimor.

**Besa Halimi – Zagragja**, për keqpërdorimin e kurseve të mësimdhënësve me nxënës, tha se është me rëndësi të dihet në rast se ato kurse kushtëzohen me shantazhim me notë etj., janë keqpërdorime të mësimdhënësve dhe duhet të lajmërohen rastet me emër dhe mbiemër. Përndryshe, pa ndihmesën e prindërve, nxënësve dhe qytetarëve të tjerë, ato nuk mund të gjenden dhe nuk mund zgjidhen asnjëherë.

Pra, duhet të ketë ankesa me emër dhe mbiemër, për t'u zgjidhur dhe për t'u formuluar si problem dhe si dukuri që po ndodh.

**Naime Osmani, pyetje për Drejtorinë e Infrastrukturës Lokale**

Është një rast urgjent lidhur me kanalizimin në shkollën e Vranidollit, që ka shpërthyer në oborr të shollës, andaj ju lus që të ndërmerren masa sa më shpejt dhe të shfrytëzohet koha sa nxënësit janë në pushim.

- Përveç trotuarit në fshatin Besi ( në lagjen e parë), për të cilën bëj kërkesë tash e disa herë, kësaj radhe bëj kërkesë që të rregullohet trotuari përgjatë magjistrales Prishtinë - Podujevë, respektivisht nga udhëkryqi për Miloshevë e deri te shkolla në Besi, mundësisht të vazhdojë deri në përfundim të lagjes së parë të Prugovcit, apo në fillim të fshatit Vranidoll.
- Kërkoj në emër të banorëve të fshatrave Besi dhe Prugovc, që të dilet e të shikohet dhe të verifikohet vendi te shkolla në Besi, që të gjendet zgjidhje për ndërtimin e një nënkalimi apo mbikalimi te shkolla në Besi.

**Sadri Ramabaja** tha se është hera e tretë që insistoj dhe nuk më jepet përgjigje. Mediet, po shpresoj se janë të gjitha këtu, edhe për një arsye, sepse ne kur shtrojmë çështje, nuk i shtrojmë thjesht sa për t'i shtruar, sa për të thënë fjalë, apo sa për të kaluar lumin. Ne jemi këtu të përgjegjshëm për të ngritur probleme ekzistuese dhe për të rregulluar çështjet që mos të marrin fund letrat e kësaj natyre, siç na erdhi kjo e INPO-së. Problemi i parë, është mungesa e cilësisë në arsim, pastaj, natyrisht që iluministët paguajnë për fëmijët e tyre çdo gjë që ata të ecin tutje. Pra, cilësia e arsimit nuk është në rritje, por në rënie. Prandaj, unë e falënderoj INPO-në për këtë vërejtje shumë serioze. Të parën do ta kisha qitur çështjen e shëndetit, siç tha kolegja këtu, është çështje e tyre pastaj.

Prandaj edhe mungon përgjigjja, qe tri mbledhje radhas, se sa profesor janë pranuar në gjimnazin "Sami Frashëri" jashtë institucionit të konkursit, në shtator, dhe në shkollat tjera. Unë e kam parasysh sa do të ishte mirë që opinionin të dijë se ai punësim është bërë me një koordinim mes nivelit qendror dhe atij lokal, duke e shkelur ligjin dhe të gjitha rregullat elementare të punës.

**Hetem Kupina** shprehu përgëzime dhe falënderime për të gjithë përfaqësuesit e drejtorive, në rastin konkret për drejtoreshën e Drejtorisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit dhe për drejtorin e Drejtorisë së Financave dhe Pronës.

**Naim Makolli:**

E para, meqë ne një kohë më përpara kemi marr vendime për ndalimin e kombibusëve nëpër qytetin e Prishtinës në trafikun urban, kohëve të fundit është shqetësuese se nëpër çdo stacion të autobusëve nëpër qytet shohim automjete të vogla që bëjnë bartjen e udhëtarëve. Është diçka edhe më shqetësuese që kur të shikosh ato automjete që bëjnë bartjen e udhëtarëve nëpër qytetin e Prishtinës me automjete të vogla, shumica prej tyre nuk kanë regjistrim të komunës së Prishtinës, pra janë edhe me regjistrime të komunave tjera.

Meqë tash në fund të vitit ishte edhe rikonfirmimi i lejeve për taksi të komunës së Prishtinës, kisha propozuar që të rritet numri i taksistëve të komunës së Prishtinës edhe për nja 50 -100 sosh, në mënyrë që nevojtarëve, të cilët kanë nevojë të ushtrojnë atë veprimtari, të paktën qytetarëve të Prishtinës, t'iu mundësojmë në mënyrë legjitime ta bëjnë atë punë.

Çështja tjetër do të ishte si kërkesë, që përveç këtij vendimi që tani veç e miratuam rreth dhënies në shfrytëzim të tokave komunale të komunës së Prishtinës disa kompanive të caktuara që kanë bërë kërkesë, me sa kam unë dijeni, ka edhe kërkesa tjera për marrje në shfrytëzim të parcelave komunale të komunës së Prishtinës, dhe kisha dashur që edhe tjera kërkesa të shqyrtohen sa më shpejt, dhe atyre personave që kanë kërkuar të zhvillojnë ndonjë biznes nëpër prona komunale, ku ka mundësi të iu jepet, të iu miratohet edhe atyre vendimi për dhënie në shfrytëzim.

Çështja tjetër ka të bëjë me ujësjellësin "Prishtina". Kjo kompani në komunën e Prishtinës ka filluar ta bëjë ndërrimin e orëve. Ndërrimin e orëve e bënë nëpërmes kompanive private, por këtu problemi është se kur bëhet ndërrimi i orës sot, ndërsa faturimi me orën e re vjen pas 2-3 muaj ditë, për këta 2-3 muaj që është faturuar, faturohet me orë të vjetër e cila nuk ekziston, mirëpo ajo shumë që faturohet për 2 muaj ditë në fund kur bëhet me letra krejt ora e re e Ujësjellësit faturohet edhe një herë. Kjo ka ndodhur në lagjen time dhe krejt lagja është faturuar për dy muaj ditë dyfish, pra është një problem që padrejtësisht dëmtohen qytetarët.

Problemi tjetër që ndërlidhte me KEK-un, është edhe çështja se shumë kompani të forta në komunën e Prishtinës bëjnë lidhje të dyfishta nëpër

trafostacionet e komunës së Prishtinës dhe problemi qëndron se në trafon ku është e regjistruar dhe kur e merr rrymën prej trafos tjetër, ata kilovatë energji që harxhohen prej trafos tjetër, i shkojnë sikur minus asaj lagjeje që furnizohen në atë trafo dhe shumë lagje të Prishtinës bien në kategorinë B ose C për këtë arsye. Pra, kjo bëhet me punëtorët e tyre.

Kisha apeluar edhe për këtë, që Kryetari i Komunës apo drejtoritë përkatëse, të merren me KEK-un për qytetarët e Prishtinës.

**Agim Dibrani**, drejtor i Drejtorisë së Ekonomisë, tha se çështja e kombibusëve është analizuar në muajin korrik, ku kemi biseduar me përfaqësuesit e tyre dhe ne kemi marr obligime që karshi përgatitjes së tyre profesionale, të iu gjejmë vende të caktuara në ndërmarrjet tona publike, që të punësohen dhe t'i ikën asaj veprimtarie, e cila është e dënueshme, mirëpo ata në përgjithësi nuk iu kanë përgjigjur.

#### **Vjollca Dibra, pyetje për Drejtorinë e Arsimit**

E dimë sigurisht se në bazë të një vendimi të Komunës, është bërë e obligueshme mbyllja e të gjitha bufeve që funksiononin nëpër shkolla. Jemi dëshmitarë të një çështjeje që nëpër disa shkolla ende po funksionojnë bufetë, ndërsa disa shkolla e kanë respektuar vendimin dhe nuk funksionojnë ato.

Unë kisha dashur të di se deri kur do të merret një vendim i njëjtë që do t'i trajtojë edhe çështjet e bufesë, sepse sigurisht ka kërkesa të mëdha, por brenda një lagjeje nuk duhet të ketë ndryshime, pra kur do të trajtohet si çështje e përbashkët për të gjitha shkollat?

**Halim Halimi** tha se me vendimin e Këshillit të Drejtorëve, është vendosur që të mbyllën bufetë, ngase e kemi parë se në shumë shkolla nuk po i plotësojnë kushtet, mirëpo në ato shkolla ku do t'i plotësojnë kushtet, ne do ta rishqyrtojmë atë vendim. Mendoj se aty ku plotësohen kushtet, duhet edhe t'i funksionalizojmë bufetë e shkollave.

**Në fund të mbledhjes, kryesuesi ua uroi të gjithëve festën e Vitit të Ri 2013.**

**Mbledhja mbaroi në orën 12:15.**

**Procesmbajtësi  
Zijadin Gashi**

**Kryesuesi i Kuvendit  
Sami Hamiti, ecc. i dipl.**